

Prof. Dr. Gazmend SHPUZA

**ROLI I EPOKËS SË SKËNDERBEUT NË KONSOLIDIMIN
E PËRBASHKËSISË ETNIKE TË NEOARBËRESHËVE
EPIROTË**

Rruga që ka ndjekur vetëpërcaktimi etnik i popullit tonë është dëshmi e historisë së tij të lashtë, e mbijetesës dhe në kushte të pavoritshme, e madje të rrezikshme për qenien e kësaj etnie. Nga ilirët e lashtë te kombësia arbëreshe mesjetare e deri te kombi shqiptar modern është një rrugë e gjatë. Në trajtimin e këtij rrugëtimi, përgjithësisht, heshtet për atë hallkë shumë të rëndësishme të tij, që lidh arbëreshët mesjetarë me shqiptarët e kohës së re. Kjo mbijetesë është realizuar përmes epirotëve të epokës skënderbeiane. Mbi këtë truall shqiptarët mbijetuan deri në ditët tona si komb i njësuar.

Mbijetesë dhe përparimi progresiv i kësaj etnie mbi dy mijë vjeçare nga ilirët e deri te shqiptarët është dëshmi e vitalitetit të bartësve të emërtimeve të saj në shekuj. Dëshmia më madhore dhe vendimtare e këtij vitaliteti është, pa dyshim, epopeja e shek. XV dhe, për vetë rrjedhimet e sundimit osman, edhe Rilindja jonë Kombëtare. Prandaj, për stërnipërit e Skënderbeut, në mënyrë të veçantë, epoka së cilës ai i dha emrin mbetet jo vetëm frymëzuese, por edhe mësimdhënëse dhe aktuale për vetë fatet që ndanë shqiptarët pas Shpalljes së Pavarësisë me vendimet e Londrës të vitit 1913. Epoka e Skënderbeut sjell mesazhin e bashkimit kombëtar në kuptimin më të plotë të kësaj fjale, jo vetëm për sot, por dhe për të ardhmen e kombit shqiptar si një i tërë.

* * *

Secili prej emërtimeve etnike, ilir, arbëresh, epirot e shqiptar, janë të lidhur ngushtë me momente shumë të rëndësishme e jetike, me momente kthese të historisë sonë kombëtare. Ecuria e tyre ka qenë e pashkëputur

nga procesi i shtetformimit në mesin e shqiptarëve. Ky proces çau rrugën e vet në rrethana tejet të vështira.

Që nga fundi i shek. XII nisi jetën e vet Principata e Arbërisë, duke shënuar një etapë të rëndësishme në jetën shtetërore të shqiptarëve. Më pas, edhe pse nën një sundimtar të huaj, u krijua në treva me popullsi, kryesisht, shqiptare, Despotati i Epirit.

Këto formacione shtetërore hapën rrugën e një tradite, e cila erdhi duke u bërë gjithnjë e më e qëndrueshme përmes së cilës u konsolidua përballë pushtetit bizantin identiteti politik i arbëreshëve. Ky realitet i ri u afirmua në marrëveshjen midis mbretit Anzhuin të Napolit dhe prijësve të këtyre trevave. Sipas saj, Karli I vendosi sovranitetin mbi territorin e cilësuar “Regnum Albania”. Për afro një shekull, ndonëse duke u rrudhur, “Mbretëria e Arbërisë” ruajti në kuptimin juridik karakterin e një shteti më vete, duke konsoliduar traditën shtetërore të shqiptarëve.

Më pas, me shembjen e Perandorisë Serbe u hap rruga e zhvillimit të lirë të principatave arbëreshe: Zenebishët, Muzakajt, Arianitët, Balshajt në Shkodër, Topiat në Durrës, Komnenët në Vlorë, Pjetër Losha dhe Gjin Bue Shpata në trevat arbërore jugore deri në Greqinë e Veriut etj.

Pas kalimit në katolicizëm, Balsha II, në vitet 70-80 të shek. XIV, mundi të bashkonte për herë të parë pjesën më të madhe të tokave arbërore që nga Himara, Vlora, Berati dhe përtej Bunës e deri në Prizren, atje ku ishte përgjithësuar emri Arbëri, që bashkonte një popullsi të lidhur nga gjuha, nga doket, nga marrëdhëniet kulturore dhe politike.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu gjatë luftërave të udhëhequra prej tij pati mirë parasysh përvojën e paraardhësve për formimin e një shteti feudal të bashkuar, edhe pse jo të përmasave perandorake. Në të gjitha këto orvatje ai u përball me konceptet teokratike të kishave dhe të shteteve ballkanike të mesjetës. Mbizotërimi i këtyre koncepteve e kishte bërë shumë të vështirë zhvillimin politik, shtetëror dhe kulturor të njësuar të arbëreshëve. Koncepte dhe kritere të tilla, në radhë të parë, vënia e shenjës së barazimit midis përkatësisë etnike dhe besimit, e vunë në rrezik mbijetesën e shqiptarëve të hershëm si njësi e përbashkuar etnike.

Skënderbeu që në fillimet e veprimtarisë së tij e pati mirë parasysh rrezikun që paraqiste për vendin e tij organizimi i luftës antiosmane të shqiptarëve mbi bazën e koncepteve teokratike. Prandaj Besë – Lidhja e Lezhës, e themeluar prej tij, edhe pse u krijua në një zotërim të një fuqie katolike, siç ishte Venediku, dhe në prani të përfaqësuesve të tij, nuk u konceptua si vegël politike e Republikës së Shën Markut. Ajo nuk do të luftonte për ruajtjen e zotërimeve të saj në Ballkanin Perëndimor. Nga ana tjetër, edhe pse në këtë tubim qenë të pranishëm edhe klerikë katolikë, kjo Lidhje, e ideuar dhe e udhëhequr prej Gjergj Kastriotit

Skënderbeut, nuk u krijua si një lidhje fetare, por si një lidhje e mirëfilltë politike shqiptare për mbrojtjen dhe çlirimin e trojeve amtare.

Si përfundim, mund të pohojmë se krerët shqiptarë, përgjithësisht, u bashkuan rreth Skënderbeut pa dallim krahine dhe besimi: ortodoksë, katolikë, apo ortodoksë që do t'i shkëpusnin lidhjet me Patrikanën dhe do të njihnin për të parë feje Papën, apo dhe islamë. Midis këtyre të fundit, pavarësisht nga konvertimet dhe rikonvertimet e njëpasnjëshme, përfshihet edhe vetë Skënderbeu, i ati i tij, Gjoni së bashku me të nipin, Hamzain, që mbante emrin mysliman të gjyshit të vet, e krerë të tjerë shqiptarë të cilët qenë vënë deri më atëherë në shërbim të sulltanit.

Skënderbeu, si burrë shteti me përfytyrime të qarta dhe largpamëse rreth të ardhmes politike të vendit të vet, ishte plotësisht i vetëdijshëm për hapat që po hidhte drejt krijimit të një shteti kombëtar të njësuar. Që në fillim të luftës së udhëhequr prej tij, ai deklaronte se donte të realizonte planet politike të Balshajve dhe shpallte se vepronte si trashëgimtar i tyre në trojet shqiptare.

Skënderbeu që në lartësinë e detyrave që shtronte koha jo vetëm në rrafsh ballkanik por edhe evropian. Në ballë të aspiratave liridashëse të popullit shqiptar ai me tejpmësi arriti të kapërcente raporte politike e shoqërore, separatiste feudale, të cilave kishte filluar t'u kalonte koha dhe ua hapi rrugën dukurive të reja shtetërore dhe juridike të përmasave evropiane në vendin tonë. Me një këndvështrim të spikatur evropian Gjergj Kastrioti luftoi për formimin e një shteti të njësuar kombëtar.

Duke pasur parasysh traditën shtetformuese paraardhëse, të nisur që me Principatën e Arbërit dhe sidomos me "Mbretërinë e Arbërisë", të konfirmuar në marrëdhëniet shtetërore ndëradriatike, Skënderbeu e qajti shtetin e vet Arbëri (Albania) dhe veten Zot i Arbërisë. Njëkohësisht, ai, ndër të parët, e kuptoi se etnonimi arbër/arbëresh ishte bërë, për shkak të politikave teokratike ballkanike, i pamjaftueshëm për shënjimin dhe përfaqësimin, pa dallim besimi, të të gjithë paraardhësve tanë në atë kohë e, pse jo, edhe më parë. Si i tillë, ai nuk i ndihmonte bashkimit të të gjitha forcave në luftë kundër marshimit të vrullshëm të osmanëve.

Nga ana tjetër, Skënderbeu, nga sa na dëshmon Papa Piu II, ka pranuar me shumë krenari prejardhjen epirote të popullit të vet. Historicizmi i tij kishte parasysh jo vetëm traditat e lashta të popullit të vet të mishëruara te Pirroja, por edhe realitetet demografike dhe historike-politike të trevave jugore të vendit. Këto anë, që nga Despotati Epirit i shek. XI-XII e deri te principatat arbërore të viseve jugore në shek. XIV-XV, edhe pse nuk kishin arritur të përfshiheshin në Principatën apo edhe në Mbretërinë e Arbërisë, ishin pjesë përbërëse e të njëjtit trung etnik. Me këtë qëndrim, në pamje të parë të dyzuar, Zoti i

Arbërisë, epiroti Gjergj Kastrioti Skënderbeu, dëshmon se ai e kishte plotësisht të qartë që edhe pse besimi katolik në atë kohë u quajt “besimi i shqiptarëve”, pra, i arbërve të mesjetës, nuk arriti të merrte, siç pretendohet, tiparet e një feje kombëtare. Mbi bazën e këtij koncepti të përparuar mbifetar të etnisë, Skënderbeu, ndërsa braktisi emërtimin arbëresh, i cili qe identifikuar me katolikun, ai nuk hoqi dorë asnjëherë, por e ruajti deri në vdekje emrin e tij mysliman Skënder. Ai, madje, nuk bëri asnjë përpjekje as për ta evropianizuar atë në trajtën e mirënjohur Aleksandër. Konsekuent në qëndrimet e veta Gjergj Kastrioti, siç provojnë të gjithë autorët që kanë shkruar për të, qe i gatshëm që për hir të interesave të atdheut të luftonte dhe luftoi kundër venedikasve, vëllezërve të një feje.

Qëndrimin në çështjen e vetëpërcaktimit etnik të Skënderbeut e kanë pasqyruar dhe madje edhe kanë përqafuar edhe vetë, pa mëdyshe, edhe biografi i tij Marin Barleti, e sidomos apologjiet i tij Frang Bardhi. Skënderbeu nga këta autorë quhet, jo rastësisht, princi i epirotëve dhe jo i arbëreshëve. Pra, në pikëpamje etnike ai dhe nënshtetasit e tij konsiderohen epirotë. Porse, nuk duhet harruar se ai emërtohet, njëkohësisht, edhe Princi i Arbërisë, duke krijuar kështu, në dukje, një mospërputhje midis etnonimit dhe makrotoponimit të shtetit që ai krijoi dhe e drejtoi për një çerek shekulli. Dhimiter Frëngu në vitin 1539 hodhi hapin e parë për kapërcimin e kësaj mospërputhjeje. Gjergj Kastriotin Skënderbeun ai e quan jo më princ të Arbërisë por princ të Epirit.

Që në fillim duhet sqaruar se kur flasim për epirotë, kemi të bëjmë me një etnonim i cili nuk kishte lidhje fare me grekët. Këta e quanin veten romaios (rum), kristianë e bizantinë, por asnjëherë deri në atë kohë nuk kishin arritur ta konsideronin veten, të paktën, helenë.

Frang Bardhi në Apologjinë e tij për heroin tonë kombëtar veten, sikurse edhe Skënderbeun, e konsideron epirot. Porse, nga ana tjetër, po veten e quan, njëkohësisht, edhe peshkop të popullit arbëresh. Në këtë rast nuk kemi një dyzim të autorit të “Apologjisë” në përcaktimin e tij vetjak nga ana etnike. Siç shihet qartë, në këtë periudhë, në të njëjtën vepër të Frang Bardhit etnonimi arbëresh kishte pushuar të përdoret si i tillë dhe fillon e dallohet nga vetëmërtimi i ri etnik epirot. Pra, kuptimi i emërtimit arbër edhe për Bardhin qe rrudhur vetëm në atë të një emërtimi të besimtarëve katolikë, përkatësisht arbëreshë të asaj kohe. Në këtë pikë peshkop Frang Bardhi dallon qartë përkatësinë fetare katolike të grigjës arbëreshe që ai udhëheq, nga përcaktimi etnik epirot, të cilit i përkasin tashmë të gjithë bashkatdhetarët e tij. Ose thënë ndryshe, sipas Skënderbeut, Barletit e të tjerëve emërtimi epirot u përket, tani e mbrapa, të gjithë pasardhësve të arbëreshëve, pa dallim besimi. Pra, autori Frang Bardhi, edhe pse prelat i kishës, si intelektual i shquar dhe atdhetar i madh i kohës së tij, i mbrujtur me idealet e epokës skënderbejane, dallon

qartë mbarë popullin e vet epirot, për të mos e ngatërruar dhe kufizuar, rrëguar, çka ndodhte rëndom në mesjetë, vetëm me besimtarët e vet, të përbërë nga arbëreshë katolikë. Ai e kishte të qartë tashmë se etnonimi i vjetruar tëhuajsonte jo vetëm arbëreshët ortodoksë por edhe të gjithë ata arbëreshë që kishin nisur të islamizoheshin. Pra, peshkop Frang Bardhi i preokupuar, siç e tregon “Apologjia” e tij, për përkatësinë kombëtare të heroit të vet, nuk shqetësohet, jo se është indiferent, për përkatësinë e tij fetare.

Tani emërtimi epirot në konceptimin e ri skënderbeian, sipas Marin Barletit, Frang Bardhit, Dhimitër Frangut e të tjerëve, përfshinte brenda trojeve etnike të gjithë arbëreshët e mëparshëm, tashmë neoarbëreshë, pavarësisht se cilit besim i përkasin apo cilën kishë ndjekin. Pikërisht në këto kushte Frang Bardhi e emërton gjuhën shqipe në atë kohë gjuhë epirote. Pas tij, shumë studiues dhe njohës të gjuhës shqipe gjatë shekujve XVI-XVII e quajnë atë po ashtu gjuhë epirote.

Etnonimi epirot nuk arriti të përfshinte edhe popullsinë neoarbëreshe jashtë trojeve etnike. Ky fakt përlligjet plotësisht me kushtet e ndryshme në të cilat jetonin neoarbëreshët në Ballkanin Perëndimor, në Italinë e Jugut dhe në Greqi. Edhe pse nuk arritën të viheshin subjektivisht nën një emërues të përbashkët etnonimik këto pjesë të popullsisë parashqiptare, në saje të vetëdijes së lartë etnike të fituar gjatë epokës skënderbeiane, mbetën të diferencuar plotësisht nga popullsia e trevave ku ata qenë vendosur.

Arbëreshët që u ngulën në Italinë e Jugut vijuan të vetëquheshin të tillë dhe jo latinë, siç u përcaktuan në vendin e prejardhjes së tyre nga sundimtarët osmanë, ndjekësit e besimit katolik. Ata qenë të vetëdijshëm se nuk kishin asgjë të përbashkët me “Itinët” (italianët) vendës, siç i quajnë edhe sot e kësaj dite.

Vëllezërit e tyre në Greqi vijuan të vetëquheshin deri në ditët tona arvanitas. Ata me gjithë besimin e përbashkët të krishterë ortodoksë, nuk u identifikuan me vendësit të cilët e quanin veten rumë, bizantinë, apo thjeshtë kristianë.

Skënderbeu dhe pas tij edhe autorët tanë të shekujve XVI-XVII u ngritën mbi konceptet fetare të përcaktimeve etnike të kohës dhe përqaftuan koncepte moderne. Kjo ishte shprehje e një vetëdijeje të lartë etnike. Ishte vetë realiteti pasarbëresh, me larminë e tij fetare, i cili diktonte një zgjidhje në përputhje me të.

Si një etnonim me prejardhje të hershme pagane, i papërlyer nga konceptet teokratike të shekujve të mesjetës, vetëmërtimi epirot në kushtet e mbizotërimit të këtyre koncepteve shërbeu për përveçimin etnik të mbarë bashkatdhetarëve të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Marin

Barletit, Frang Bardhit, Dhimitër Frangut e të tjerëve, pa dallim feje, si nga fqinjët ashtu edhe nga sundimtarët e huaj.

“Braktisja” e etnonimit të mëparshëm arbëresh dhe përqaftimi, më pas, i emërimit të ri kombëtar epirot dhe më pas shqiptar u realizua brenda trojeve shqiptare, sepse pikërisht këtu mbijetesa etnike, kombëtare, e njësuar e paraardhësve tanë ndeshje për jetë a vdekje me politika shtetërore dhe fetare asimiluese, përthithëse, dhe për rrjedhim, edhe përçarëse, të mbështetura në identifikimin e besimit me kombësinë.

Politikat e kishave ortodokse ballkanike të vënies së shenjës së barazimit midis besimit dhe kombësisë u institucionalizuan me vendosjen e sistemit osman të mileteve. Nën këtë sistem dhe nën këto politika mesjetare shqiptarët, të ndarë deri më tani midis dy kishave dhe që po fillonin të përqaftonin masivisht edhe një besim të ri, rrezikonin fatalisht të humbisnin kombësinë e tyre. Sipas besimeve, ata, tani, zyrtarisht i përkasin miletit islam (turk), miletit rum, d.m.th. ortodoks (grek) dhe miletit latin (katolik). Ata, sipas besimeve që ndiqnin, konsideroheshin jo vetëm nga kishat por edhe nga administratat ballkanike turq, grekë, latinë dhe sllavë.

Në këto rrethana komplekse sistemi osman i mileteve, me gjithë karakterin e tij liberal, të pranuar nga shkencat turkologjike, pati pasoja tejet të rënda për zhvillimin e njësuar kombëtar të paraardhësve të shqiptarëve plurikonfesional sidomos në fushën e arsimit e të kulturës, rrjedhimisht edhe në rrafshin fetar. Në këto rrethana etnonimi epirot nuk arriti të ngulitej brenda vendit dhe banorët e tij përqaftuan emërtimin shqiptar.

Një riemërtim i tillë në rrafsh etnik i të njëjtës popullsi, sado e çuditshme dhe e pabesueshme që të na duket, nuk mund të kryhej pa ndihmesën, ndikimin dhe jehonën e epokës skënderbeiane. Roli i saj në këto drejtime ka qenë, për mendimin tonë vendimtar. Prandaj, nuk na duket ndonjë guxim i tepruar në rrafsh shkencor të pohojmë se shqiptarët nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit Skënderbeut gjatë gjithë këtyre shekujve kanë pasur reagim programatik, harmonik për të përbashkuar dhe kapërcyer proceset ndarëse dhe për t’u hapur rrugën atyre përbashkuese në gjirin e shtetasve të vet, duke bërë të mundur ngjizjen e sintezës së re mbifetare epirote, gjegjësisht shqiptare. Në këtë mes nuk kemi të bëjmë me kurrfarë rastësie të mrekullueshme. Këtë rastësi, nëse mund ta quajmë kështu, e bëri të mundshme lufta e popullit shqiptar dhe politika largpamëse e ndriçuar nga idetë iluministe të Rilindjes Evropiane, e Skënderbeut dhe lufta e udhëhequr prej tij.

Ndërrimi i emrit etnik nga vetë shqiptarët iu kundërvu politikës djallëzore të shkombëtarizimit dhe të përçarjes së të parëve tanë nga ana

e sundimtarëve osmanë dhe e kishave ballkanike. Kjo shënon kundërvënien e parë të madhe dhe të suksesshme të shqiptarëve, si komb, ndaj këtyre politikave, në radhë të parë, ndaj sistemit osman të mileteve. Por vlen të theksohet dhe të kihet mirë parasysh, se ajo nuk drejtohej kundër islamizimit apo islamizmit, siç pretendohet në ndonjë rast, qoftë edhe pa dashje.

Sa u përpoqëm të vëmë në pah më sipër, mund të arrihet në përfundimin se roli vendimtar i epokës skënderbeiane në konsolidimin e vetëdijes etnike mbifetare të neoarbëreshëve epirotë dhe në ngulitjen dhe thellimin e traditës shtetformuese të shqiptarëve nuk kufizohet vetëm në shek. XV. Skënderbeu i bashkoi shqiptarët si askush tjetër jo vetëm në shek. XV, por edhe më pas e deri në ditët tona.

* * *

Epokës skënderbeiane nuk mund t'i drejtohesh duke e reduktuar rëndësinë dhe karakterin e luftës së shqiptarëve të udhëhequr nga një hero kombëtar si Skënderbeu, të rritur midis feve, në një luftë me karakter fetar të "kryqit" kundër "gjysmëhënës". Vetë Gjergj Kastrioti, jo vetëm që nuk është shprehur për një karakter të tillë të minimizuar të luftës së udhëhequr prej tij, por ka bërë plotësisht të qartë me vepra se do të luftonte kundër kujtdo që do të cenonte interesat e atdheut të tij, pavarësisht se nën cilën shenjë fetare fshihej rreziku për popullin dhe atdheun e vet. Prandaj, miti i Gjergj Kastriotit Skënderbeut si Hero Kombëtar mbijetoi midis shqiptarëve edhe pasi shumica tyre përqafoi islamizmin. Skënderbeu i rritur midis feve, u bë për pasardhësit, duke filluar me rilindësit, simbol i karakterit mbifetar që duhej të kishte kultura shqiptare dhe lufta e tyre për çlirim kombëtar.

Përpyekjet që bëhen për ta parcializuar fetarisht Skënderbeun me pretendimin se gjithë kjo do të lehtësonte integrimin e Shqipërisë në Evropë nuk përputhen me realitetin historik të shek. XV dhe më pas. Ky "patriotizëm fetar" që po shfaqet sot, nuk mund të përliqet me të ashtuquajtura vështrime "të reja". Në të vërtetë, kemi të bëjmë veçse me një rikthim të një mendësi parakombëtare.

Historia e shqiptarëve që nga shekulli XV, trajtimi i trashëgimisë historike kombëtare kryekëput mbi kritere fetare është tepër i ngushtë dhe i njëanshëm dhe tejet i dëmshëm, për të mos thënë më shumë, për gjykimin dhe vlerësimin e realitetit shqiptar qysh nga shekulli XV e këtej. Në këtë konceptim, si thirrjet për ta shpallur Skënderbeun shenjt, si trajtesat "shkencore" të nivelit pasuniversitar për shkurorëzimin e vijës politike të "skenderbegasve" përballë vijës, të pretenduar, "nacionaliste"

të "vasalistëve" çojnë në minimizimin e vlerave historike e kombëtare të epokës së Skënderbeut, deri në zhvlerësimin tërësor të saj.

Përvoja skënderbeiane na mëson bindshëm se integrimi i kombit tonë në Evropë nuk mund të bëhet mbi baza fetare. Shqiptarët do të "shkojnë" në Evropë si shqiptarë, Shqipëria do të "hyjë" në Evropë përmes Shqipërisë, përmes fesë së shqiptarëve që është e mbetet shqiptaria dhe kurrësi mbi bazën e një platforme fetare; por përkundrazi. Përkundrejt saj ne kemi platformën e bashkëjetesës ndërfaqetare tradicionale që e karakterizon popullin tonë dhe që e dallon nga shumë kombe të qytetëruara perëndimore dhe pikërisht për këtë i bën nder të veçantë dhe e rreshton denjësisht përkrah tyre.

Skënderbeu mbetet mishërim i idealit patriotik, i idealit të unitetit kombëtar, i virtyeteve më të mira të popullit të vet. Në këtë vit jubilar të lindjes së tij, Fishta i madh na kujton dhe na mëson shumëçka. Përkundrejt pretendimeve se Skënderbeu ishte vetëm një fatos feje, Patër Gjergji thekson se në një vështrim shkencor të paanshëm ishte "fatosi i lirisë dhe i pavarësisë së kombeve". Sipas këtij françeskani, "dëshira e lirisë që ajo që ma së pari e shtyni atë burrë të përmendun me rrokë armët për Shqipërinë. Skënderbeu me atë trimni e reptësi, me të cilën luftoi kundër turqve që ishin myslimanë, luftoi, vijon autori i "Lahutës", edhe kundër venedikasve që ishin të krishtenë". Fishta përfundon se të gjithë "shqiptarët e vërtetë, pa ndërlikime partie a besimi, do ta nderojnë Skënderbeun si një fatos të kombit". Do të ishte në nderin e të gjithëve "me kremtue emnin e punën e tij. Skënderbeu asht ideal i lirisë dhe i pavarësisë së Shqipërisë".

Skënderbeu objektivisht, i shërben fuqishëm përfshirjes së popullit tonë në rrjedhat demokratizuese moderne evropiane, të cilave ai u përkiste tërësisht qysh në fillimet e tyre, që para afro 600 vjetëve, jo vetëm me luftën e tij por edhe me pikëpamjet e veta.